



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 906 Prot.

Tiranë, më 28.04.2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 37 Datë 28.04 2026

**PËR**  
**NJË NDRYSHIM NË KLASIFIKIMIN E KATEGORISË PËR PERSONELIN**  
**AKADEMIK PRANË FAKULTETIT TË VEPRIMTARISË FIZIKE DHE**  
**REKREACIONIT DHE PËRCAKTIMIT TË PAGËS NË UNIVERSITETIN E**  
**SPORTEVE TË TIRANËS**

Në vijim të shkresës së Ministrisë së Arsimit me nr. 1847/1, datë 30.03.2026 “*Dergim i raportit përfundimtar të auditimit*”, në VKM me nr. 243, datë 20.04.2023 “Për një ndryshim në VKM nr.748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë*”, si dhe në Vendimin e Rektoratit nr. 72, datë 27.04.2026 “Për një ndryshim në klasifikimin e kategorise për personelin akademik pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, në Vendimin e Senatit Akademik me nr. 68 datë 28.04.2026 “Për një ndryshim në klasifikimin e kategorise për personelin akademik pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 28.04.2026,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë ndryshimin e kategorisë së personelit akademik nga “Lektor” në “Asistent Lektor” për,
  - **Msc. Henri Dibra**, personel akademik pranë Departamentit të Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
  - **Msc. Ornela Marko**, personel akademik pranë Departamentit të Lëvizjes dhe Shëndetit, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
2. Niveli i pagës do të jetë sipas Vendimit të Bordit të Administrimit me nr. 50, datë 31.10.2022 “Miratimi i nivelit të pagave sipas VKM në nivel maksimal të personelit akademik të UST”.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Njësitë Kryesore, Administratori, Drejtoria e Burimeve Njerëzore Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Artur COBANI**

